



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 335 Prot.

Tiranë, më datë 09 .08 .2024

VENDIM
Nr. 293, datë 09.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.08.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit e rezultatit të sondazhit arkeologjik në kuadër të projektit “Rikonstrukcion objekt ekzistues 1 kat me shtesë anësore dhe shtesë 1 kat, Rruga Kasëm Durrësi” me aplikues z. Taulant Rama dhe zhvillues z. **Ilir Shehdula**;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë monitorimin arkeologjik të punimeve në kuadër të projektit “Rikonstrukcion objekt ekzistues 1 kat me shtesë anësore dhe shtesë 1 kat, Rruga Kasëm Durrësi” me aplikues z. Taulant Rama dhe zhvillues z. **Ilir Shehdula**, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 3. Subjekti zhvillues të vijojë procedurën për miratim sipas ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
 4. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shyrtim dhe vendimmarje në KKTKM;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

KRYETAR
Blendi GONXHJA

